

|   |                                     |                         |
|---|-------------------------------------|-------------------------|
| Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo<br>Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës<br>Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova<br>Civil Aviation Authority of Kosovo |                                     |                         |
| CAA   |                                     |                         |
| Nr. i prot. <b>2025/ZDP/84</b>  |                                     |                         |
| Br. prot./Prot. br.   | Kopje                               | Data: <b>26/02/2025</b> |
| Faqe: <b>3</b>  | Kopje/Copy                          | Datum/Date              |
| Stranica/Pages  | Kopija/Copy                         |                         |
| Hyrje/ulaznin   | <input type="checkbox"/>            |                         |
| Dalës/izlazno/out   | <input checked="" type="checkbox"/> |                         |
| Brendshëm/intermodal  | <input type="checkbox"/>            |                         |
| Prishtinë/Prština/Pristina  |                                     |                         |

03/ZDP/VE/2025  
Datë: 26 shkurt 2025

Në mbështetje të nenit 14.1, 14.2, 15.1 (f), 21.2 dhe 81 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, i ndryshuar me Ligjin nr.08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura dhe nenit 13.1 të Rregullores (AAC) nr. 3/2015 mbi tarifën e aeroportit (mëtuje Rregullorja),

Duke vendosur sipas propozimit final të operatorit të aeroportit, LKIA ANP "Adem Jashari" ("operatori i aeroportit"), të dt. 21 shkurt 2025, për aprovim të Programit Nxitës 2025-2029 me nr. Prot. 2025/BNRREA/74,

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës nxjerr këtë:

#### VENDIM

1. Aprovohet Programi Nxitës 2025-2029 i ANP "Adem Jashari", i dt. 21 shkurt 2025 me nr. protokollit 2025/BNRREA/74, i vlefshëm në periudhën 30 mars 2025 – 24 mars 2029.
2. Aprovimi i AAC-së mbulon vetëm produktet të cilat prekin tarifën e rregulluar nga AAC-ja respektivisht **Nxitjen për zhvillimin e destinacioneve të reja, Nxitjen për zhvillimin e frekuencave shtesë, Nxitjen për stacionimin e aeroplanëve dhe Nxitjen për zhvillimin e destinacioneve të largëta.**
3. Obligohet Operatori i aeroportit t'u ofrojë Programin Nxitës të gjitha kompanive ajrore që operojnë në ANP "Adem Jashari" LKIA në mënyrë transparente dhe jo-diskriminuese dhe të publikojë këtë program në faqen e tij zyrtare në internet.
4. Operatori i aeroportit obligohet që në baza vjetore të raportojë në AAC mbi zbatimin e këtij programi.
5. Çdo ndryshim i programit nga operatori i aeroportit duhet të aprovohet nga AAC-ja.
6. Kompanitë ajrore mund të ankohen në AAC në rast se janë të pakënaqur me zbatimin e Programit Nxitës nga operatori i aeroportit.
7. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

#### ARSYETIM

Me qëllim të marrjes së aprovimit të AAC-së për produktet 6.1 Nxitja për zhvillimin e destinacioneve të reja, 6.2 Nxitja për zhvillimin e frekuencave shtesë, 6.3 Nxitja për stacionimin e aeroplanëve dhe 6.4 Nxitja për zhvillimin e destinacioneve të largëta të përfshira në Programin Nxitës, operatori i aeroportit ka dorëzuar këto dokumente për shqyrtim:

1. Propozimin fillestar të programit nxitës me titull "Draft Programi Nxitës 2025-2029" me numër të protokollit 2025/BNRREA/38, dt. 30 janar 2025;
2. Komunikimin elektronik të datës 30 janar 2025 prej LKIA te kompanitë ajrore me titull "LKIA Draft Incentive Program 2025-2029", përmes të cilit kërkojnë komentet në programin nxitës deri më 10 shkurt 2025;
3. Listën e pranuesve të komunikimit të lartë përmendur të dt. 30 janar 2025;
4. Komentet e kompanive ajrore: Ajet Airlines, Condor Flugdienst, Easyjet Airline, GP Aviation dhe Trade Air të përcjella nga LKIA në AAC përmes e-mailit me dt. 18 shkurt 2025;
5. Propozimin final të Programit nxitës 2025-2029 me nr. prot. 2025/BNRREA/60 të dt. 14 shkurt 2025;
6. Propozimin final të plotësuar e ndryshuar të Programit nxitës 2025-2029 me nr. prot. 2025/BNRREA/74 të dt. 21 shkurt 2025;
7. Dokumenti "Përmbledhje e konsultimit me kompanitë ajrore" në të cilin janë analizuar komentet e kompanive ajrore nga operatori i aeroportit, dorëzuar nga LKIA me dt. 18 shkurt 2025;
8. Analiza e kostos dhe benefitit të programit nxitës të dt. 14 shkurt 2025, dokument i cili tregon parashikimin e të hyrave dhe kostove operuese të gjeneruara nga secili produkt nxitës (impaktin e programit nxitës) në përputhje me Nenin 12 të Rregullores;
9. Informatat dhe spjegimet e prezantuara nga LKIA gjatë takimit midis zyrtarëve të departamentit për bashkëpunim ndërkombëtar dhe rregullim ekonomik të aviacionit në AAC dhe zyrtarëve përgjegjës të LKIA për secilin produkt veç e veç të mbajtur me datën 7 shkurt 2025.

Në bazë të detyrave dhe përgjegjësiave të AAC-së sipas nenit 15.1 (f) të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, me ndryshime si dhe nenit 8 të Rregullores (AAC) nr. 3/2015 për tarifatat e aeroportit, AAC-ja ka bërë shqyrtimin e këtyre dokumenteve dhe ka konstatuar se:

- Kriteret për dhënien e produkteve nxitëse 6.1 Nxitja për zhvillimin e destinacioneve të reja, 6.2 Nxitja për zhvillimin e frekuencave shtesë, 6.3 Nxitja për stacionimin e aeroplanëve dhe 6.4 Nxitja për zhvillimin e destinacioneve të largëta të ofruara në Programin Nxitës të propozuara nga operatori i aeroportit e të cilat rregullohen nga AAC-ja janë relevante, objektive dhe transparente në përputhje me Nenin 8 të Rregullores;
- Programi Nxitës i ofrohet të gjitha kompanive ajrore pa asnjë përjashtim të cilat bartin udhëtarë dhe operojnë ose planifikojnë të operojnë nga ANP "Adem Jashari" dhe të cilat plotësojnë të gjitha kriteret;
- Programi Nxitës është i kufizuar në kohë dhe është efektiv në periudhën Sezoni Veror i IATA 2025 – Sezoni Dimëror i IATA 2028 domethënë prej 30 mars 2025 – 24 mars 2029;
- Konsultimi me përdoruesit është bërë në periudhën 30 janar 2025 - 10 shkurt 2025 dhe në bazë të listës së kompanive ajrore të konsultuara është vërtetuar se janë konsultuar jo vetëm kompanitë që operojnë momentalisht në aeroport por edhe ato që kanë operuar ose planifikojnë të operojnë;
- Kompanitë ajrore kanë dhënë komente përmbajtësore jo vetëm në programin nxitës por kanë dhënë ide edhe për produkte nxitëse tjera për të cilat ata kishin shprehur interesim më të madh siç është nxitja për çdo udhëtar të bartur;
- Kompanitë ajrore kanë pasur më së shumti komente lidhur me kriteret që duhet të plotësohen për të fituar nxitjen për stacionimin e aeroplanëve. Ato kanë arsyetuar secilën kërkesë sa i përket fleksibilitetit, arritjes së objektivave dhe kufizimeve operacionale. Sa i përket këtij produkti nxitës operatori i aeroportit ka vendosur të marrë parasysh disa nga këto kërkesa dhe ka bërë këto ndryshime në propozimin final:
  - Kriteri për rritjen e numrit të operimeve nga viti në vit është lehtësuar nga 5% në 3%;
  - Kriteri për realizimin e 85% të operimeve në kohë të saktë është hequr ndërsa ka mbetur si rekomandim teknik ngase kompanitë ajrore kanë dëshmuar se operimi në kohë është jo gjithmonë në kontrollin e tyre;

- Kriteri për numrin e anulimeve të lejuara gjatë vitit është lehtësuar duke u rritur nga 5% në 10%;
- LKIA ka pranuar të ndryshojë propozimin që të merren parasysh rekomandimet e AAC-së të prezantuara gjatë takimit të datës 07 shkurt 2025 e që kanë pasur të bëjnë kryesisht rre saktësimin dhe thjeshtësimin e kriterëve në mënyrë që të inkurajojnë kompanitë ajrore për të aplikuar. Poashtu sipas kërkesës së AAC programi është kufizuar në kohë dhe është hequr kufizimi për madhësinë e aeroplanit që kualifikohet për nxitje për të pasur më shumë fleksibilitet.
- Nga të dhënat e ofruara për të hyrat e parashikuara dhe shpenzimet si rezultat i nxitjeve të ofruara konstatohet se LKIA do të gjenerojë të hyra neto shtesë, pra se nxitjet e aprovuara nga AAC do të kenë efekt pozitiv në biznesin e aeroportit.

Përmes korrespondencës elektronike të dt. 18 shkurt 2025 AAC ka dërguar për dijeni e komente te Departamenti Qendror për Partneritet Publiko Privat i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve propozimin final të programit nxitës, Departamenti Qendror për Partneritet Publiko Privat i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve nuk ka dhënë ndonjë koment dhe ka udhëzuar AAC-në që të vazhdojë që brenda kompetencave dhe autorizimeve të tij të ushtrojë përgjegjësitë, duke marr parasysh edhe dispozitat nga Marrëveshja PPP-ANP.

Duke marrë parasysh se Programi nxitës 2025-2029 i propozuar nga operatori i aeroportit është një iniciativë transparente dhe inkurajim i mirë për kompanitë ajrore që të fillojnë zhvillimin e destinacioneve të reja, frekuencave shtesë, stacionimin e aeroplanëve dhe zhvillimin e destinacioneve të largëta në ANP "Adem Jashari", është i kufizuar në kohë (vlen për katër vite), është proporcional me arritjen e objektivit të synuar dhe i ofrohet të gjitha kompanive ajrore pa përjashtim, mund të përfundohet se, si i tillë, ky program është në interes të përgjithshëm publik dhe në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, të ndryshuar dhe nenit 13.1 të Rregullores (AAC) nr. 3/2015 për tarifatat e aeroportit.

Duke u mbështetur mbi këtë që u tha më lartë, Drejtori i përgjithshëm ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

  
**Burim Dinarama**  
UD Drejtor i përgjithshëm

Udhëzim mbi mjetin juridik:

Kundër këtij Vendimi mund të kërkohet rishikim administrativ pranë Komisionit të Ankesave të AAC-së, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të Vendimit.

Iu dërgohet:

- Operatorit të ANP "Adem Jashari" LKIA
- Departamentit Qendror PPP, MFPT
- Departamentit të Aviacionit Civil, MMPHI